



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.735/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e Srdjan Stojanovic, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gracaninë, nga radhët e subjektit politik PDS, dega në Gracaninë, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i Srdjan Stojanovic, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gracaninë, nga radhët e subjektit politik PDS, dega në Gracaninë, me shenjën ZL.Anr.735/2017 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017, nga Srdjan Stojanovic, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gracaninë, nga radhët e subjektit politik PDS, dega në Gracaninë, me të cilën ka pretenduar se në bazë të listës së kandidatëve për anëtar në KK Graçanicë dhe të mandateve të shpërndarë, të publikuar nga KQZ-ja, me datë 08.11.2017, duke konsideruar se me një ndarje të tillë të vendeve, është dëmtuar më një masë të madhe e drejta e tij. Më tej ka theksuar se me vendimin e KQZ-së, mandatet për komunën e Graçanices janë, për listën e PDS-së, shpërndahen, përveç bartësit të listës, edhe një kandidati me numër rendor 6, Sanja Mladenovic, e cila në total ka fituar 40 vota, çka është për 179 vota më pak se numri prej 219 votuesve të cilët e kanë votuar, ku me një veprim të tillë janë shkelur të gjitha parimet ndërkombëtare demokratike. Gjithashtu, ka theksuar se me vendim të ndryshuar të KQZ-së nuk do të shkelet dispozita për barazi gjinore, sepse fakti është që numri i mandateve që ndahen gjinisë më pak të përfaqësuar, do të jetë 30% siç e parashih edhe vetë ligji, duke pasur parasysh, se mandati i këshilltareve më pak të përfaqësuar, është shpërndarë për 5 kandidatë të Listës Serbe dhe një kandidati nga lista e Samostalna Liberalna Stranka (SLS). Me shpalljen e mandateve nga KQZ-ja, vetëm se dëmtohet vullneti i lirë i qytetareve nga Komuna e Graçanices, dhe për këtë arsye ka kërkuar që KQZ-ja të rishqyrtojë vendimin e saj, dhe të vendos që mandati për KK Graçanica i jepet kandidati Srdjan Stojanovic, nga PDS-ja, në bazë të votave të fituara.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur edhe Listën e kandidatëve nga PDS-ja, sipas numrit të votave të fituara.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruara në apel, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve të parashtruara në apel gjeti se apeli është e pabazuar sepse respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt dhe po që se përfaqësimi është 50% nga kjo rezulton se nuk është në kundërshtim me ligjin, duke u bazuar në nenin 27.1 të LZP ku përcaktohet se: *“Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë”.*

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.735/2017 më datën 11.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*